

Emri i Lëndës : E Folura në Publik

Kodi	Tipi i lëndës	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
COM 304	B	6	3	0	0	3.00	6
Lektori dhe orari i konsultimeve			Ramadan Cipuri, PhD				
Asistenti dhe orari i konsultimeve							
Gjuha e kursit			Albanian				
Niveli i lëndës			Bachelor				
Përshkrimi			Gjatë gjithë historisë së njerëzimit njerëzit e kanë përdorur të folurin në publik si një mënyrë vitale komunikimi. Të folurit në publik është një mënyrë e bërjes publike të ideve; e ndarjes së këtyre ideve me njerëzit e tjerë dhe një mënyrë e ndikimit të individëve. Në kurs do të flitet për artin e të folurit në publik dhe do të analizohen të gjithë faktorët që ndikojnë në përgatitjen dhe mbajtjen e një fjalimi të mirë para publikut. Që një komunikim i tillë të jetë efikas, duhen njohur mirë elementet që përfshihen gjatë një ndërveprimit të tillë. Analiza e audiencës, puna kërkimore paraprake, zgjedhja e temës, hartimi i fjalimit në mënyrë të strukturuar, mposhtja e etheve të skenës dhe arti i të bindurit janë disa nga çështjet që do të trajtojmë së bashku.				
Objektivat			Në fund të kësaj lënde, studenti do të jetë i familjarizuar me paraqitjen e një ligjërate të mirëargumentuar dhe mirëprezantuar, të përshtatshme me situatën përkatëse. Për të bërë këtë, do të përqëndrohet në disa aspekte si: Çfarë do të thotë të jesh një folës dhe dëgjues etik i mesazheve? Identifikimi i elementeve qëndrorë për një mesazh logjik dhe të mirëorganizuar; Identifikimi dhe prezantimi i llojeve të ndryshme të ligjëratave etj				

Programi i Lëndës

Java	Tema
1	Hyrje në artin e të folurit në publik; Tradita e folurit në publik; Ngjashmëritë dhe dallimet midis të folurit në publik dhe bisedimit- Të folurit publik dhe mendimi kritik.
2	Analiza e audiencës; Fokusimi te audience; Psikologjia e audiencës; Analiza demografike e audiencës; Analiza e audiencës sipas situatës; Marrja e informacioneve mbi audiencën
3	Zgjedhja e një teme dhe qëllimi; Zgjedhja e një teme; Përcaktimi i qëllimit të përgjithshëm dhe specifik; Formulimi i idesë kryesore
4	Etika dhe të folurit në publik; Rëndësia e etikës; Këshilla për të folurit etik; Plagjiatura; Këshilla për dëgjimin etik Dëgjimi; Dëgjimi dhe të menduarit kritik; Shkaqet e dëgjimit të dobët
5	Mbledhja e materialeve; Përdorimi i njohurive dhe i përvojave vetjake; Kërkimi në bibliotekë; Kërkimi në internet; Intervista; Këshilla për punën kërkimore
6	Organizimi i pjesës kryesore të fjalimit- Pikat kryesore- Materialet mbështetëse
7	Fillimi dhe fundi i fjalimit; Hyrja; Konkluzioni; Skicimi i fjalimit; Skica e përgatitjes; Skica e mbajtjes së fjalimit
8	Përdorimi i gjuhës; Kuptimi i fjalëve; Përdorimi i saktë dhe i qartë i fjalëve; Përdorimi i përshtatshëm i gjuhës
9	Mbajtja e fjalimit; Metodot e mbajtjes së fjalimit; Zëri i folësit; Trupi i folësit
10	Përdorimi i mjeteve ndihmëse pamore; Llojet e mjeteve ndihmëse pamore; Përdorimi i Power Point-it
11	Llojet e fjalimeve; Të flasësh për të informuar; Të flasësh për të bindur
12	Metodat e bindjes; Ndërtimi i besueshmërisë; Përdorimi i evidencës; Arsyetimi; Tërheqja emocionale (patosi)
13	Fjalimet për raste të veçanta; Fjalime prezantuese; Fjalime dorëzimi të një vlerësimi publik; Fjalime pranimit të një vlerësimi publik; Fjalime përkujtimore; Fjalimet e pasdarkave

14	Fjalimet në grupe të vogla; Çfarë është një grup i vogël?; Udhëheqja dhe përgjësitet në grupe të vogla; Metodatat e mendimit reflektues; Prezantimi i mendimeve të grupit
15	Përsëritje, prezantim i projekteve studentore
16	Provimi Final

Parakushtet	
Literatura	<ul style="list-style-type: none"> • Lucas E., Stephen; Arti i të folurit në publik, UET Press, Tirana, 2011 • Vehbiu, Ardian; Shqipja totalitare - Tipare të ligjërimit publik në Shqipërinë e viteve 1945-1990; Botimet Çabej; Tirana 2007
Referenca të tjera	<ul style="list-style-type: none"> • Sprague, Jo; Stuart, Douglas; The speaker's compact handbook; Wadsworth Centage Learning, 2010 • Public Speaking and presentations; The MC-Graw - Hill Companies; 2010
Punë laborator	
Përdorimi i komp.	
Të tjera	

Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat

1	Studentët do të përvetësojnë njohuri mbi paraqitjen e një ligjërate të mirëargumentuar dhe mirëprezantuar, të përshtatshme me situatën përkatëse.
2	Studentët do të zhvillojnë mendimin kritik mbi perceptimin e mesazhit të shpërndarë dhe analizimin e audiencës para dhe pas ligjërimit publik
3	Studentët do të jenë në gjendje të identifikojnë elementët qëndrorë për një mesazh logjik

Mënyra e Vlerësimit të Lëndës

Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja
Gjysmë finale	0	0
Kuize	0	0
Projekte	1	20
Projekte semestrare	1	20
Punë laborator	0	0
Pjesëmarrja në mësim	1	20
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final		60
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final		40
Total		100

Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)

Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	3	48
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	2	28
Detyra	2	30	60
Gjysmë finale	0	0	0
Provimi final	1	15	15
Të tjera	0	0	0
Ngarkesa totale e orëve			151
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			6,04

ECTS	6
-------------	----------